

Vendim nr. 170 datë 19.07.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marsida Xhaferllari, Anëtare
Marjana Semini, Anëtare

në datën 19.07.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 18 (Sh) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: SHOQËRIA “R & B” SH.P.K.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve 9781, datë 13.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 2437, datë 01.12.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2023-5497, datë 22.12.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “t”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Pronarët e një pasurie të paluajtshme në Tiranë në vitin 2005 kanë lidhur një kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë “R & B” sh.p.k. për ndërtimin e një objekti nga kjo e fundit në truallin e tyre. Në bazë të nenit 5 të kontratës, kërkuesja merre përsipër që të siguronte lejen brenda një periudhe 7-mujore pas dorëzimit të dosjes së plotë në bashki dhe brenda 12 muajve pasuese të ndërtonte objektin sipas kontratës, duke parashikuar dhe penalitete për çdo muaj vonesë. Neni 9 i kontratës parashikonte kushtin zgjidhës, sipas të cilit, në rastin e refuzimit përfundimtar të lejes së ndërtimit, kontrata do të konsiderohej e përfunduar.

2. Rezulton se kërkuesja nuk i ka përmbushur në kohë detyrimet që rridhnin nga kontrata e sipërmarrjes për përgatitjen e dosjes dhe kryerjen e aplikimit për lejen e ndërtimit. Për rrjedhojë, leja është refuzuar përfundimisht nga Bashkia e Tiranës në vitin 2008, për shkak se lejet e ndërtimit u bllokuan me planin e ri urbanistik që u miratua për atë zonë. Pas pothuajse 5 vjetësh, në vitin 2013, pronarët e truallit i janë drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, duke kërkuar në mënyrë të përmbledhur konstatimin e përfundimit të kontratës së sipërmarrjes, fshirjen e shënimeve për pasurinë nga regjistri i pasurive të paluajtshme dhe detyrimin e kërkueses për të paguar 4000 euro në muaj për periudhën qershor 2010 – qershor 2013, me arsyetimin se e ka përdorur pasurinë e tyre për biznes. Ndërsa kërkuesja ka ngritur kundërpadi, duke kërkuar shpërblimin e dëmit dhe fitimin e munguar në vlerën 100.000.000 lekë, për shkak të zgjidhjes së kontratës së sipërmarrjes.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9781, datë 13.10.2014, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë së pronarëve për pjesën e konstatimit të përfundimit të kontratës së sipërmarrjes dhe fshirjen e shënimeve përkatëse në regjistrin e pasurive të paluajtshme, si dhe rrëzimin për pjesët e tjera të saj. Ndërsa ka rrëzuar tërësisht kundërpadinë e kërkueses si të pabazuar në ligj dhe në prova.

4. Kundër vendimit kanë ushtruar ankim të dyja palët. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2437, datë 01.12.2015, me të njëjtin arsyetim, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

5. Ndonëse kërkuesja ka paraqitur rekurs, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2023-5497, datë 22.12.2023, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqet e parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

6. Në datën 16.05.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Ankimi pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 29.05.2024.

II

Pretendimet e kërkueses

7. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjykatat i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës në drejtim të:
- 7.1. *Së drejtës aksesit substancial*, për shkak të shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit në Gjykatën e Lartë, ndërkohë që kërkuesja ishte duke u përgatitur për shqyrtimin e saj në seancë gjyqësore. Për më tepër, rekursi është shqyrtuar në një datë më të hershme nga pritshmëria e kërkueses, e cila ishte e bindur për zhvillimin e seancës gjyqësore në muajin shkurt 2024, sipas shënimit të gjyqtares relatores në kërkesën e kërkueses për përshpejtim.
 - 7.2. *Së drejtës për t'u mbrojtur dhe dëgjuar*, pasi për shkak të shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit në Gjykatën e Lartë, kërkueses i është mohuar e drejta për të paraqitur argumente dhe prova të mëtejshme në mbështetje të rekursit, të cilat për rrjedhojë nuk janë administruar nga ajo gjykatë.
 - 7.3. *Së drejtës për një gjykatë të caktuar me ligj*, pasi gjykimi i kësaj çështjeje në gjykatën e shkallës së parë është bërë nga një gjyqtar i vetëm, pavarësisht se neni 35 i KPC-së në kohën e gjykimit të çështjes parashikonte se çështja, për shkak të vlerës së kërimit, duhej të ishte gjykuar me trup gjykues, nëse një gjë e tillë kërkohej nga palët në seancë përgatitore.
 - 7.4. *Së drejtës për gjykim të drejtë dhe publik*, pasi gjykimi i çështjes në gjykatën e shkallës së parë është bërë në mungesë të plotë të transparencës, pasi i gjithë procesi është zhvilluar në zyrën e gjyqtarit, duke mënjanuar sistemin e regjistrimit audio.
 - 7.5. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi gjykata e shkallës së parë nuk e ka formuar drejt ndërgjyqësinë, duke mos thirrur Bashkinë e Tiranës në cilësinë e personit të tretë në gjykim. Për pasojë, hetimi i kryer ka qenë i paplotë dhe jo i gjithanshëm dhe konkluzionet e arritura në lidhje me thelbin e çështjes kanë qenë të gabuara. Kjo shkelje procedurale është lejuar dhe nga dy gjykatat e tjera.
 - 7.6. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi të tria gjykatat kanë interpretuar dhe zbatuar gabim ligjin, duke mos vlerësuar drejt shkakun ligjor të padisë dhe natyrën juridike të objektit të gjykimit. Arsyetimet e gjykatave janë në kundërshtim me provat që ndodhen në dosje. Gjykatat kanë pranuar gabimisht disa fakte, me qëllimin për të përligjur qëndrimin e mbajtur prej tyre. Përveç kësaj, ato gjykata nuk kanë arsyetuar mospranimin e fakteve të pretenduara nga kërkuesja.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuësja të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

9. Në këtë këndvështrim, Kolegji vlerëson se kërkuësja, si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në proceset gjyqësore në të cilat janë dhënë vendimet e kundërshtuara prej saj, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Kriteri i *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës kërkon që kërkuësi t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që kërkuësi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 24, datë 27.04.2023; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Lidhur me pretendimet për cenimin e së drejtës për një gjykatë të caktuar me ligj, të asaj për gjykim të drejtë dhe publik, si dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, Kolegji vëren se kërkuësja nuk i ka ngritur më parë në ankim ose rekurs, por i ka parashtruar për herë të parë në ankimin kushtetues individual. Për rrjedhojë, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, për këto pretendime kërkuësja nuk ka shteruar mjetet në dispozicion.

12. Ndërsa për pretendimet për cenimin e *së drejtës së aksesit, së drejtës për t'u mbrojtur dhe dëgjuar, si dhe standardit të arsytimit të vendimit*, Kolegji vëren se kërkesja i është drejtuar Gjykatës pasi ka shteruar të paktën në substancë mjetet e ankimit ose pretendimin e ka lidhur me procesin në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka më mjete në dispozicion për kundërshtim, përveç ankimit kushtetues individual. Për rrjedhojë, kërkesja i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për këto pretendime.

13. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastet e kundërshtimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor, duke filluar nga data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin në shqyrtim, Kolegji konstaton se procesi gjyqësor ka përfunduar me vendimin e datës 22.12.2023 të Gjykatës së Lartë dhe, sipas informacionit të kësaj të fundit, është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 20.02.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 16.05.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

14. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, Kolegji konstaton se pretendimet për të cilat kërkesja ka shteruar mjetet juridike hyjnë *prima facie* në juridiksionin kushtetues, prandaj ato do të shqyrtohen në vijim për bazueshmërinë e tyre.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit substancial

15. Pretendimet e kërkeses ngrihen në drejtim të shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit, ndërkohë që ajo ishte duke u përgatitur për shqyrtimin e çështjes në seancën gjyqësore. Për më tepër, rekursi është shqyrtuar në një datë më të hershme nga pritshmëria e kërkeses, e cila ishte e bindur për zhvillimin e seancës gjyqësore në muajin shkurt 2024, bazuar në shënimin e gjyqtarës relatores në kërkesën e kërkeses për përshpejtim.

16. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se nëse mohohet e drejta e aksesit, procesi konsiderohet i parregullt, sepse ajo, përpara së gjithash, është kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimin nr. 31, datë 03.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo e drejtë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr.17, datë 24.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar, gjithashtu, se shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e

këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Nëse Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Referuar dispozitave që rregullojnë rekursin në Gjykatën e Lartë, Kolegji vëren se shqyrtimi në atë gjykatë kalon në një ose në dy faza. Neni 480 i KPC-së parashikon shqyrtimin e tij në lidhje me kushtet e pranueshmërisë në dhomën e këshillimit. Më tej, në rastin kur rekursi plotëson kushtet e pranueshmërisë, çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore, si rregull, në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve (neni 482 i KPC-së) ose në prani të palëve (neni 482/a i KPC-së), shqyrtim për të cilin palët njoftohen për ditën, orën dhe përbërjen e trupit gjykues, përmes shpalljes në mjediset e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjyqimit.

18. Në rastin në shqyrtim, Kolegji konstaton se rekursi është paraqitur nga vetë kërkuesja nëpërmjet mbrojtësit të saj, ku janë parashtruar shkaqet për prishjen e vendimeve të gjykatave më të ulëta. Në vijim të pranimin të kërkesës së saj për përsheptimin e gjyqimit, është planifikuar shqyrtimi brenda muajit shkurt të vitit 2024 dhe më pas, në datën 01.12.2023, Gjykata e Lartë ka shpallur në faqen e saj zyrtare listën e çështjeve të planifikuara për shqyrtim në dhomën e këshillimit nga Kolegji Civil (trupi gjykues përkatës) në datën 22.12.2023, mes të cilave edhe çështjen e kërkueses. Në këtë mënyrë, kërkuesja, vetë ose nëpërmjet avokatit, ka pasur mundësinë dhe kohën e nevojshme për të ushtruar të drejtat e saj procedurale.

19. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, Kolegji vlerëson se kërkuesja ka ushtruar lirisht të drejtën e saj të paraqitjes së rekursit dhe se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pasi ka parashtruar shkaqet e rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, i ka vlerësuar ato dhe ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nga kërkuesja ishte haptazi i pabazuar dhe ka vendosur mospranimin e tij. Në këtë kuptim, rezulton se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë që është marrë në dhomën e këshillimit në funksion të shqyrtimit paraprak të rekursit, nuk cenon të drejtën e aksesit. Kolegji vlerëson se ajo gjykatë ka vepruar në përputhje me kompetencat e saj dhe me parashikimet ligjore që gjejnë zbatim gjatë asaj faze të shqyrtimit të çështjes në atë gjykatë. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit substancial, është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u mbrojtur dhe dëgjuar

20. Kërkesja pretendon se për shkak të shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit në Gjykatën e Lartë, i është mohuar e drejta për të paraqitur argumente dhe prova të mëtejshme në mbështetje të rekursit, të cilat rrjedhimisht nuk janë administruar nga ajo gjykatë.

21. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se e drejta për t'u dëgjuar ka për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që, përpara marrjes së vendimit gjyqësor, ai të dëgjohet realisht për thelbin e çështjes (*shih vendimet nr.7, datë 12.03.2010; nr.12, datë 06.06.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, ajo nuk është një e drejtë absolute dhe nuk konsiderohet e cenuar vetëm për shkak të shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, për sa kohë që individi ka pasur mundësinë që të paraqesë pretendimet e tij në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 23, datë 04.04.2024; nr. 14, datë 05.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). E drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur nuk nënkupton vetëm atë për t'u dëgjuar personalisht përpara gjykatës, por ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra mbi komentet dhe shpjegimet e dhëna me shkrim nga palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Duke iu referuar fakteve të çështjes konkrete në shqyrtim përpara tij, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje mbi bazën e rekursit të kërkeses, i cili është regjistruar në datën 12.02.2016. Në datën 02.10.2023 kërkesja ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për përsheptimin e gjykimit të çështjes, e cila rezulton se është pranuar dhe çështja është planifikuar të shqyrtohet brenda muajit shkurt 2024. Sipas të dhënave të faqes zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë, rezulton se në datën 01.12.2023 është publikuar lista e çështjeve që do të gjykoheshin në dhomën e këshillimit të datës 22.12.2023, si dhe përbërja e trupit gjykues dhe ora e shqyrtimit të çështjes, ku përfshihej edhe çështja e kërkeses.

23. Kolegji vëren se në fazën e shqyrtimit paraprak, Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje në bazë të rekursit të paraqitur nga kërkesja, e cila ka pasur mundësinë të parashtrojë të gjitha pretendimet e saj në lidhje me procesin gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e faktit dhe vendimmarrjet e tyre. Për rrjedhojë, nuk provohet që ajo të jetë vendosur në pozita të pafavorshme në krahasim me palën tjetër në proces në drejtim të së drejtës për t'u dëgjuar në aspektin substancial. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkeses për cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur dhe dëgjuar është i pabazuar.

Ç. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

24. Kërkesja ka pretenduar se të tria gjykatat kanë interpretuar dhe zbatuar gabim ligjin, duke mos vlerësuar drejt shkakun ligjor të padisë dhe natyrën juridike të objektit të gjykimit dhe se arsyetimet e tyre janë në kundërshtim me provat që ndodhen në dosje. Ato gjykata nuk kanë arsyetuar mospranimin e fakteve të pretenduara nga kërkesja.

25. E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 9, datë 23.02.2023; nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimet për mospranimin e rekursit mund të arsyetohen nga Gjykata e Lartë në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese, me përjashtim të rastit kur kjo mënyrë veprimi e gjykatës së zakonshme provohet se ka cenuar të drejta kushtetuese të individit, në kuptimin që procesi në tërësinë e tij rezulton haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 32, datë 03.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pranuar se ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 34, datë 12.06.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në rastin në shqyrtim, në lidhje me pretendimet për cenimin e këtij standardi nga gjykatat e faktit, vërehet se gjykata e shkallës së parë në vendimin e saj ka marrë në shqyrtim, analizuar dhe vlerësuar në mënyrë të argumentuar pretendimet dhe provat e palëve, ka konstatuar se është vërtetuar kushti zgjidhës i parashikuar në kontratën e sipërmarrjes, pra refuzimi i lejes së ndërtimit me shkresën e Bashkisë së Tiranës nr. A17289/1 prot., datë 23.10.2008, dhe ka konstatuar përfundimin e kontratës. Në të njëjtën linjë, Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, pasi e ka gjetur të bazuar në ligj

dhe në prova. Nga ana tjetër, ajo i ka vlerësuar të pabazuara pretendimet e ngritura në ankimin e kërkuësës. Nuk rezulton që ato gjykata të jenë shmangur nga analiza dhe vlerësimi i provave shkresore ose kërkesave të paraqitura nga kërkuësja. Përkundrazi, rezulton se ato gjykata kanë marrë në shqyrtim, analizuar dhe vlerësuar në mënyrë të argumentuar dhe ezaruese pretendimet dhe provat e kërkuësës dhe, brenda kompetencës së tyre, kanë arritur në konkluzione të caktuara (*shih faqet 7 – 13 të vendimit nr. 9781, datë 13.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*). Vetëm fakti se konkluzionet e gjykatave të faktit nuk kanë shkuar në favor të pretendimeve të kërkuësës, nuk vë në dyshim të drejtën e tij për proces të rregullt ligjor.

28. Lidhur me vendimin e Gjykatës së Lartë, vërehet se ajo e ka shqyrtuar rekursin e kërkuësës në dhomën e këshillimit, duke vlerësuar se nuk plotësonte kriteret e pranueshmërisë për shqyrtimin në themel, pasi shkaqet e parashtuara në të nuk u referoheshin shkaqeve të nenit 472 të KPC-së. Shkaqet e tjera të paraqitura në rekurs janë vlerësuar se ngrenë çështje të vlerësimit të provave dhe fakteve, të cilat dalin jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafin 14 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Vendimi në tërësinë e tij paraqitet i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje dhe arsyetimi i kufizuar i tij është në përputhje me standardet e Gjykatës për këto lloj vendimesh, duke përmbushur kriteret në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

29. Për sa më lart, vendimet gjyqësore në tërësi nuk rezultojnë të jenë alogjike dhe të kenë kundërthënie, ndërsa pjesa arsyetuese e tyre lidhet me përfundimin e arritur në dispozitiv, duke plotësuar kështu kërkesat e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në vijim, vlerësohet se ndaj kërkuësës është zhvilluar një proces i rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, për rrjedhojë pretendimi i saj për cenimin e këtij standardi është haptazi i pabazuar.

30. Pjesa e argumenteve për cenimin e standardit të arsyetimit të lidhur me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, si dhe vlerësimin e provave, janë të natyrës ligjore dhe kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të provave dhe zbatimit të ligjit, të cilat, si rregull, janë atribut i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues, për rrjedhojë nuk mund të merren në shqyrtim.

31. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.